

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Ardijana Reshtani, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. K., nga fshati D., komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të KP-së. sipas aktakuzës të Prokurorisë themelore në Prizren PP.nr.3387/2015 të datës 19.11.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren, Besim Susuri, të akuzuarit, me datë 24.08.2016, publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A. K., nga i ati R. dhe e ëma Z. e lindur M., i lindur me datë *data e lindjes...*, në fshatin D., komuna e Gjakovës, ku edhe jeton, ka të kryer shtatë klasë të shkollës fillore, momentalisht i papunë, i martuar, baba i pesë fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së dobët ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 12.10.2015, rreth orës 11:20 minuta, me qëllim të vjedhjes në Rajonin Ekonomiko Pyjor “Pashtriku 1”, në vendin e quajtur “Lugu i Zi”, Rajoni mbrojtës “Kuzhnini i Hasit”, ka prerë dru, të llojit frashër – lejthi – pajë, me vëllim të përgjithshëm prej 3,10 m³, ndërsa Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural – Autoritetit Komunal Pyjor në Prizren, i shkakton dëm në shumën prej 635,50 euro.

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të KP-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7,41,49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75, 76 dhe 358 par.1 të KP-së. të KP-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nën kërcnim të ekzekutimit të dhunshëm.

E dëmtuara Autoriteti Komunal Pyjor në Prizren, për realizimin e kërkesës pronësoro juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.3387/2015 të datës 19.11.2015, kundër të akuzuarit A. K., nga fshati D., komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të KP-së.

Prokurori i shtetit Besim Susuri, në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: qëndroj në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.3387/2015 të datës 19.11.2015, kundër të akuzuarit A. K., nga fshati D., komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të KP-së, dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu i akuzuari në shqyrtimin e sotëm gjyqësor në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale si në akuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysht të gjitha rrethanat cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese të merr parasysht pranimin e fajësisë nga i akuzuari në mënyrë vullnetare për veprën penale e cila i vihet në barë

I akuzuari A. K., në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: e pranoj fajësinë për veprën penale e cila më vihet në barë, është e vërtetë që unë për shkak të kushteve të vështira ekonomike kam qenë në rajonin pyjor Pashtriku, për të mbledhur disa copëza të drurit me djalin tim, dhe atë për të siguruar diçka për nxemje për dimër. Nuk e di se ku ka qenë as roja e pyllit, e as nuk e di që kam vërejtur dikë në ditën kritike. Por pasi që është ngritur kjo akuzë ndaj meje, e pranoj veprën penale në mënyrë vullnetare, por i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë, sjelljen time korekte para gjykatës, që jam person familjar, baba i pesë fëmijëve, dhe me punën time të kohëpaskohëshme kujdesem për ekzistencën e familjes sime dhe atë me punën time që për shkak të pasojave të luftës nuk e kam shëndetin e plotë. Andaj i propozoj gjykatës që të gjitha të cekurat më lartë gjykata ti ketë parasysht si rrethanat lehtësuese me rastin e marrjes të vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Me datë 12.10.2015, rreth orës 11:20 minuta, i akuzuari me qëllim të vjedhjes në Rajonin Ekonomiko Pyjor “Pashtriku 1”, në vendin e quajtur “Lugu i Zi”, Rajoni mbrojtës “Kuzhnini i Hasit”, ka prerë dru, të llojit frashër – lejthi – pajë, me vëllim të përgjithshëm prej 3,10 m³, ndërsa Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural – Autoritetit Komunal Pyjor në Prizren, i shkakton dëm në shumën prej 635,50 euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit i cili në shqyrtimin fillstar vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak se cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale.

Gjykata ka ardhë në përfundim, se pranimi i fajsis nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të KP-së, dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me kusht paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjshmërinë e tij penale juridike.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethanë rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajsisë nga ana e të akuzuarit sjellja korrekte e tij pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë i tij, gjer më tani i pa gjykuar, çka nënkupton se nuk kanë ardhur ndesh me rregullat pozitive, në kuptim të dispozitave të nenit 74 gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit, moshën e të akuzuarit, është person familjar, baba i pesë fëmijëve, bashkëpunimin e përgjithshëm të akuzuarit me gjykatën, pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, shprehja e keqardhjes të akuzuarit për veprën penale të shkaktuar, si dhe sjelljen korrekte të tij gjatë shqyrtimit si dhe pas veprës penale të shkaktuar, andaj gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë të tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe shpenzimet mbi paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Vendimin mbi udhëzimin e të dëmtuarës në kontestin e rregullt civil gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1929/2015 me datë 24.08.2016

Procesmbjatesja
Ardijana Reshtani,

Gjyqtari,
Luan Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.